



Pranimar / Dorezuar Prenheno/Prodato Received/Delivered	10.01.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRINISHTAK	148/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.538/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.1815/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.745/2019 të datës 03.12.2019 të parashtruar nga ankuesi _____ nga Prishtina, kundër Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 10.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.745/2019 e datës 03.12.2019, e parashtruar nga ankuesi _____ lidhur me kompensimin e 50% të pagës së Drejtorit të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, prej datës 12.12.2014 deri me datë 11.11.2015.**
- II. Refuzohet pretendimi ankimor për kthimin e ankuesit në vendin e punës si Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, lejimin e ushtrimit të mandatit të mbetur prej njëmbëdhjetë (11) muajve, dhe kompensimin e pagesave nga dhjetori 2015 e tutje.**
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, duke bërë kompensimin e pagës e 50% të pagës për ankuesin _____ prej datës 12.12.2014 deri me datë 11.11.2015.**
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi Basri Muja, i punësuar sipas Vendimit me numër Nr.04/100 të datës 12.11.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në vendin e punës Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës

në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, më datë 03.12.2019 ka parashtruar ankesë për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit, sipas procedurës së filluar me kërkesën me numër protokoll 3438 të datës 12.09.2019 drejtuar Ministrinë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, lidhur me kthimin e tij në vendin e punës si *Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës*, me propozimin që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të marr vendim për kthimin e tij në vendin e punës si *Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës*, vazhdimin e mandatit të mbetur prej njëmbëdhjetë (11) muajve, kompensimi i pagesave të mbetura nga dhjetori i vitit 2015, si dhe kompensimi i 50% të ardhurave personale për periudhën dhjetor 2014-nentor 2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.12.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tel Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa më datë 23.12.2019, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në periudhën Janar 2019 – Tetor 2020, ka qenë jo funksional dhe si rrjedhojë nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje, kështu që përmes shkresës me numër protokoll 183/2020 të datës 22.01.2020 ka njoftuar ankuesin për mungesën e kuorumit dhe ka udhëzuar të njëjtin për ndjekjen e procedurave të mëtejme në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 07.06.2021 me Aktgjykimin me numër A.nr.663/2020 (të pranuar me datë 16.06.2021) ka detyruar Këshillin që brenda afatit prej 30 ditësh të vendos për ankesën me numër A.nr.745/2019 të datës 03.12.2019, mirëpo Këshilli përsëri në mungesë të kuorumit për vendimmarrje ka udhëzuar të njëjtin që të ndjek procedurën e mëtejme në gjykatë. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.nr.1815/2021 (te pranuar nga Këshilli me datë 12.12.2022 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën me numër A.nr.745/2019 të datës 03.12.2019 të parashtruar nga ankuesi

Këshilli, duke marr parasysh se tani kanë pushuar rrethanat për të cilat nuk ishte shqyrtuar ankesa e ankuesit nga fakti se tani Këshilli është funksional, dhe duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.1815/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi për trajtimin e ankesës A.nr.745/2019 të datës 03.12.2019, ku për vendosje meritori Kolegji i Këshillit administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 5656/2019 të datës 03.12.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim me numër A.nr.1815/2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 29.11.2022 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 12.12.2022; Njoftim me numër protokoll 3716/2021 i datës 14.07.2021; Njoftim me numër protokoll 3717/2021 i datës 14.07.2021; Urgjencë për shqyrtimin e çështjes nga ankuesi me numër protokoll 3804/2021 i datës 21.07.2021; Autorizim nga për avokatin i datës 06.08.2020; Aktgjykim me numër A.nr.663/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative i datës 07.06.2021 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 16.06.2021; Fletëkthesë e datës 12.03.2020; Fletëkthesë e datës 14.07.2021; Fletëkthesë e datës 22.01.2020; Fletëkthesë e

datës 09.12.2019; Njoftim me numër protokoll 183/2020 i datës 22.01.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.12.2019; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 5896/2019 i datës 23.12.2019; Lista e pagave të ankuesit për periudhën dhjetor 2014 deri janar 2016; Pliko me numër R8804151; Pliko me numër R1750239; Shkresë provat; Informim me numër protokoll 3559 i datës 15.11.2019; Ankesë e ankuesit drejtuar Komisionit për ankesa për pozita të nivelit të lartë drejtues me numër protokoll 3418 i datës 11.11.2019; Kërkesë për vërtetim me shkrim për përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje i datës 14.11.2019; Kërkesë për kthim në vendin e punës me numër protokoll 3438 i datës 12.09.2019; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për krime të rënda PKR.nr.476/15 i datës 29.01.2019; Vendim për pezullim të përkohshëm nga puna me numër protokoll 428/14 i datës 12.12.2014; Vendim me Nr.04/100 i datës 12.11.2012; Vendim me numër protokoll 65/09 i datës 23.03.2009; Kontratë e Punës e B.M. e datës 02.04.2010; Kontratë e Punës e _____ e datës 14.04.2008.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të pranuar nga ankuesi dhe organi përkatës i punësimit, konstatoi se ankesa e ankuesit Basri Muja, është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi me Vendimin me numër Nr.04/100 të datës 12.11.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ishte emëruar *Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës* në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me mandat tre (3) vjeçar, dhe atë nga data 12.11.2012 deri me datë 12.11.2015.

I njëjti me Vendimin Nr.197/01B të datës 12.12.2014 të Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, është pezulluar nga marrëdhënia e punës me arsyetimin se ankuesi gjendet në arrest shtëpiak nën akuzën për kryerje të veprës penale. Rrjedhimisht Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin me numër PKR.nr.476/15 të datës 21.01.2019 (i plotfuqishëm nga data 26.08.2019), ka refuzuar akuzën e ngritur ndaj ankuesit Basri Muja për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor si pasojë e parashkrimit absolutë të veprës penale për të cilën akuzohej.

Pas pranimit të Aktgjykimit me numër PKR.nr.476/15 të datës 21.01.2019 (i plotfuqishëm nga data 26.08.2019) ankuesi përmes shkresës me numër protokoll 3438 të datës 12.09.2019 i është drejtuar Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me kërkesë për kthimin e tij në vendin e punës si *Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës*. Mirëpo, meqenëse nuk pranon përgjigje nga organi përkatës i punësimit, i njëjti me datë 03.12.2019 për shkak të heshtjes administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për kthimin e tij në vendin e punës si *Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës*, vazhdimin e mandatit të mbetur prej njëmbëdhjetë (11) muajve, kompensimi i pagesave të mbetura nga dhjetori i vitit 2015, si dhe kompensimi i 50% të ardhurave personale për periudhën dhjetor 2014-nentor 2015.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (i aplikueshëm në kohën e pezullimit nga marrëdhënia e punës e ankuesit me datë 12.12.2014), përkatësisht dispozitat e nenit 69 ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj*



është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjyqimit; 1.3. kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet. 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. 3. Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi, dhe si rrjedhojë duke marr parasysh se ankuesi me Vendimin Nr.197/01B të datës 12.12.2014 është pezulluar nga marrëdhënia e punës për shkak të akuzës për kryerje të veprës penale, dhe meqenëse i njëjti në shkresa të lëndës ka sjellë si dëshmi Aktgjykimin me numër PKR.nr.476/15 të datës 21.01.2019 lidhur me refuzimin e aktakuzës ndaj tij për të cilën akuzë i njëjti ishte pezulluar nga marrëdhënia e punës me datë 12.12.2014, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimi ankimor për kompensimin e 50% të ardhurave personale për periudhën 12.12.2014-12.11.2015 është i bazuar.

Ndërsa, nga administrimi i shkresave të lëndës si dhe analizimi i bazës ligjore, Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me kthimin në vendin e punës si Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, lejimin e ushtrimit të mandatit të mbetur prej njëmbëdhjetë (11) muajve, dhe kompensimin e pagesave nga dhjetori 2015 e tutje, nuk është i bazuar, ngase ankuesi me Vendimin me numër Nr.04/100 të datës 12.11.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është emëruar Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me mandat tre (3) vjeçar, dhe atë nga data 12.11.2012 deri me datë 12.11.2015, sipas dispozitave të nenit 15 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit mandati tre (3) vjeçar sipas Vendimit me numër Nr.04/100 të datës 12.11.2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kalimin e kësaj kohe është konsumuar, konstatim ky i cili gjënë mbështetje edhe në vlerësimin e Gjykatës se Apelit të dhënë në Aktgjykimin AA.nr.403/2016 të datës 05.11.2019 me rastin e vendosjes për çështje me objekt të njëjtë, ku është konstatuar se: "...sipas nenit 15 par 3 të Ligjit për Shërbimin Civil mandati për pozitën e nivelit të lartë drejtues janë me afat të caktuar tre vjeçar. Ndërsa sipas nenit 90 par 2 dhe 3 të Ligjit për shërbimin civil rregullohet mënyra e përfundimit të marrëdhënies së punës sipas kontratës me afat të caktuar, e që marrëdhënia e punës përfundon me skadimin e kontratës së punës". Kështu që duke marr parasysh faktin se ankuesi ishte emëruar sipas dispozitave të nenit 15 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me mandat për kohë të caktuar, tre (3) vjeçare, Kolegji i Këshillit konstaton se mandati për të cilin është emëruar ankuesi, për shkak të kalimit të kohës është konsumuar, andaj pretendimi ankimor për kthimin e tij në pozitën e punës si Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, dhe lejimin e ushtrimit të mandatit të mbetur prej njëmbëdhjetë (11) muajve është i pa bazuar, ashtu sikurse është i pa bazuar edhe pretendimi ankimor për kompensimin e të gjitha pagesave nga muaji dhjetor 2015 e tutje, sepse ankuesit i ka përfunduar mandati i rregullt si Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, me datë 12.11.2015, dhe se organi i punësimit nuk kishte asnjë marrëdhënie kontraktuale me ankuesin pas datës 12.11.2015.

Kolegji i Këshillit, po ashtu, lidhur pretendimin ankimor të ankuesit për ruajtën e statusit të nëpunësit civil ka analizuar dispozitat e Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 89 ku përcaktohet se: *Pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil 1. Për*

qëllime të këtij ligji, rastet në vijim konsiderohen pezullim i dakorduar nga shërbimi civil: 1.1. pushimi pa pagesë; 1.2. transferimi i përkohshëm në detyra të tjera brenda ose jashtë Kosovës; 1.3. marrjes së detyrës së funksionarit publik; 1.4. kryerja e obligimeve ushtarake. 2. Pas mbarimit të kushtit të pezullimit të dakorduar, nëpunësi civil ruan të drejtën e kthimit në pozitën e mëparshme ose në një pozitë ekuivalente, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se ankuesi me rastin e emërimit Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, pozitë kjo e kategorisë së lartë në Shërbimin Civil, nuk ka plotësuar asnjërin nga kushtet e përcaktuara për pezullimin e marrëdhënies së punës, gjegjësisht ruajtjen e statusit të nëpunësit civil, ngase me këtë dispozite ligjore nuk parashihet mundësia e pezullimit të pozitës me rastin e emërimit të nëpunësit civil në pozitë të lartë drejtuese, siç është rasti i ankuesit, kështu që Kolegji i Këshillit vlerëson së pretendimi ankimor i ankuesit për ruajtjen e statusit të nëpunësit civil nuk është i bazuar.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për aprovimin e pjesërisht të ankesës lidhur me kompensimin e 50% të ardhurave personale për periudhën 12.12.2014-12.11.2015, ndërsa vendosi për refuzimin e pretendimit ankimor lidhur me kthimin në vendin e punës si Drejtor në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, lejimin e ushtrimit të mandatit të mbetur prej njëmbëdhjetë (11) muajve, kompensimin e pagesave nga dhjetori 2015 e tutje, si dhe ruajtjen e statusit të nëpunësit civil.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.538/2021

Aydyll Bekteshi

Procesmbajtës

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Ministritë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- Arkiviot të KPMSHCK-së;